



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

---

**NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI**

Rasti: Përfitim Kontrolli Vienna Insurance Group AG / Intersig Sh.a

Në datën 1 Shtator 2011, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të marrëveshjes për shitblerje aksionesh, të nënshkruar ndërmjet palëve (Vienna Insurance Group AG dhe Intersig Sh.a), më datë 24 Gusht 2011 me objekt përfitim e kontrollit të shoqërisë Intersig Sh.a , me anë të transferimit të 75% +1 të aksioneve tek Vienna Insurance Group AG.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- Për **Vienna Insurance Group AG**: kryen menaxhimin strategjik dhe disa nga funksionet kryesore te grupit VIENNA INSURANCE GROUP duke përfshirë edhe infrastrukturën. Gjithashtu shoqëria kryen edhe aktivitetin e sigurimit të aksidenteve dhe të sigurimit të pronës si dhe aktivitet risigurimi në degët për të cilat ka marrë autorizim nga autoriteti përkatës ;
- Për **Intersig Sh.a**: ushtron veprimtarinë e saj në fushën e sigurimeve të jo-jetës e licencuar më 13.09.2001 nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve (aktualisht AMF). Aktivitetet kryesore të shoqërisë përfshijnë sigurimin për automjetet, shëndetin, pronësinë etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit 9121 "Per mbrojtjen e konkurrencës".

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr "Sami Frashëri", Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)**